



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:111163
Datë: 11.06.2024
Numri i dokumentit: 05810426

KE.nr. 329/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Kompania e Sigurimeve "ELSIG" Sh.A me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "EUROSIG" Sh.A., me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompensim në bazë të regresit, jashtë seancës me datë 11.06.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

KONSTATOHET e tërhequr padia e ushtruar nga paditësi Kompania e Sigurimeve "ELSIG" Sh.A kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "EUROSIG" Sh.A., me objekt kontesti kompensim në bazë të regresit.

A r s y e t i m

Kompania e Sigurimeve "ELSIG" Sh.A. me seli në Prishtinë, me datë 15.04.2024 ka paraqitur padi kundër të paditurit Kompania e Sigurimeve "EUROSIG" Sh.A., me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompensim i dëmit.

Paditësi, me parashtrësën e datës 11.06.2024, e ka njoftuar Gjykatën se për këtë çështje juridike e tërheqë padinë e parashtruar me datë 15.04.2024, për arsye se me të paditurit kanë arritur një pajtim jashtëgjyqësor.

Andaj Gjykata duke vepruar sipas parashtrësës së përfaqësuesit të paditësit, në kuptim të nenit 261 lidhur me nenin 387.1 pika c) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr. 329/24, datë 11.06.2024

Gjyqtari
Florent Zeqiri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, nuk është e lejuar ankesa.